

Rritja e reformave të sektorit të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut përmes analizës aktive të sistemit dhe reflektimeve me më shumë palë të përfshira

Udhërrëfyes, tregues i performancës për vlerësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit në sektorin e zbulimit dhe sigurisë së Maqedonisë së Veriut

Ky udhërrëfyes është pjesë e ndërhyrjes "Rritja e reformave të sektorit të inteligjencës dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut përmes analizës aktive të sistemit dhe reflektimeve me shumëpalë të interesuara" të prodhuar në kuadër të **Programit të reformës së sektorit të zbulimit dhe sigurisë të zbatuar nga DCAF në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021-2026)**. Ky udhërrëfyes pasqyron dhe përmbledh gjetjet - praktike dhe instrumentale – duke bazuar në dëshmi dhe të dhëna primare cilësore të marra nga intervistat, pyetësorët e hapur dhe diskutimet nominale në grup me përfaqësues nga sektori i zbulimit dhe sigurisë dhe aktorët e paravarur.

Pikëpamjet e shprehura në këtë udhërrëfyes janë ato të C3I dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e DCAF, donatorëve ose institucioneve të referuara ose të përfaqësuara në kuadër të këtij publikimi.



Autori:

Metodi Haxhi-Janev
Ljubica Pendaroska Krstevska (autore kontribuese)
Dimitar Bogatinov (autor kontribues)

Përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

Jetmir Ziba

Redaktor:

Marija Jankuloska

Titulli Origjinal:

Enhancing the Intelligence and Security Sector Reforms in North Macedonia through Active System Analysis and Multi-Stakeholder Reflections: *"Roadmap with Performance Indicators for Assessing Transparency, Accountability, and Effectiveness in the Intelligence and Security Sector of North Macedonia"*

© DCAF, 2024. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Shkup, 2024

Për DCAF

DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje me Sektorin e Sigurisë angazhohet për rritje të cilësisë së sigurisë së vendeve dhe popujve në ato vende brenda qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit, respektit ndaj të drejtave të njeriut, dhe barazisë gjinore. Që nga themelimi në vitin 2000, DCAF ka kontribuar duke rritur qëndrueshmërinë e paqes dhe zhvillimit përmes ndihmës ofruar shteteve partnere, dhe përmes mbështetjes që palët ndërkombëtare u ofrojnë këtyre shteteve për të rritur cilësinë e qeverisjes në sektorin e sigurisë me reforma gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje të të gjitha palëve. DCAF harton materiale njohurie që janë inovative, promovon normat dhe praktikrat e mira, ofron këshilla ligjore dhe të politikbërjes dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve që veprojnë në fushën e sigurisë- qofshin ato shtetërore apo jo.

DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance
Maison de la Paix
Chemin Eugène-Rigot 2E
CH-1202 Geneva, Switzerland
Tel: +41 22 730 94 00
info@dcaf.ch
www.dcaf.ch
Twitter @DCAF_Geneva

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

351.74.07(497.7)(047.31)
355.3.07(497.7)(047.31)
355.40.07(497.7)(047.31)

HAXHI-Janev, Metodi

Rritja e reformave të sektorit të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut përmes analizës aktive të sistemit dhe reflektimeve me më shumë palë të përfshira [Elektronски извор] : udhërrëfyes, tregues i performancës për vlerësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit në sektorin e zbulimit dhe sigurisë së Maqedonisë së Veriut / [autori Metodi Haxhi-Janev ; Ljubica Pendaroska Krstevska (autore kontribuese), Dimitar Bogatinov (autor kontribues) ; përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe Jetmir Ziba]. - Shkup : DCAF - Qendra e Gjenevës për Qeverisje me Sektorin e Sigurisë, 2024

Начин на пристапување (URL):

<https://c3initiative.com/mk/category/aktivnosti/>. - Текст во ПДФ формат,

11 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 18.09.2024. - Превод на делото: Enhancing the intelligence and security sector reforms in North Macedonia through active system analysis and multi-stakeholder reflections : roadmap with performance indicators for assessing transparency, accountability, and effectiveness in the Intelligence and Security Sector of North Macedonia

ISBN 978-608-5046-02-7

1. Pendaroska Krstevska, Ljubica [автор] 2. Bogatinov, Dimitar [автор]

а) Безбедносен сектор -- Добро управување -- Патоказ на индикатори -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 64435717

PËRKUFIZIMET

Transparenca e sektorit të sigurisë presupozon publicitet, qasshmëri dhe dukshmëri të veprimeve, masave, kostove dhe efekteve të një aktiviteti. Është kritike në sigurimin e qeverisjes së mirë të sektorit të zbulimit dhe sigurisë dhe përfaqëson hapjen ndaj mbikëqyrjes publike duke ofruar mundësi për qasje në informacione, rregullore, aktivitete dhe procese.

Llogaridhënia është ekzistenca e mekanizmave që sigurojnë që sektori i sigurisë të mbahet përgjegjës për ndërmarrjet, veprimet dhe mënyrat se si kryen detyrat e tij. Llogaridhënia mund të marrë një formë të përgjegjësisë së butë dhe të vështirë dhe mund të jetë horizontale ose vertikale. Supozimet për llogaridhënie efektive të sektorit të sigurisë gjithmonë nënkuptojnë shoqëri të fortë civile, institucione të konsoliduara dhe mbështetje legjislative.

Parimet e 'transparencës dhe llogaridhënies' janë vendimtare në parandalimin e keqpërdorimit të sektorit të sigurisë për qëllime politike, si dhe parandalimin e praktikave të korrupsionit. Këto parime janë thelbësore në sigurimin e besimit të publikut dhe legjitimitetit të institucioneve të sigurisë.

Efikasiteti dhe **efektiviteti** janë dy parime të ndërthurura që i referohen cilësisë së përgjithshme të rezultateve të ofrimit të sigurisë. Efektiviteti i referohet masës në të cilën institucionet e zbulimit dhe sigurisë përmbushin rolet dhe përgjegjësitë e tyre sipas standardeve më të larta. Efiçenca, nga ana tjetër, nënkupton përmbushjen e këtyre roleve dhe përgjegjësisive me shfrytëzimin optimal të burimeve publike.¹

Digjitalizimi i sektorit të sigurisë është një proces i ndikimit në formën/mënyrën se si puna e sektorit të sigurisë është optimizuar duke përdorur mjete digjitale. Zhvillimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) hap mundësi të reja për përmirësimin e performancës, optimizimin e kapitalit dhe burimeve njerëzore, mbikëqyrje dhe kontroll më të mirë dhe gjithëpërfshirje më të madhe të aktorëve të pavarur në proceset e reformës, monitorimit dhe mbikëqyrjes. Transformimi digjital duhet të përfshijë informacionin që është i disponueshëm, i formatuar dhe i automatizuar në mënyrë që të rritet efikasiteti, transparenca dhe hapja ndaj kontrollit.

MBËSHTETJA E DIGJITALIZIMIT TË SEKTORIT TË ZBULIMIT DHE SIGURISË TË MAQEDONISË SË VERIUT NDËR TË TJERA, DO TË:

- rris funksionalitetin e përgjithshëm,
- përmirësojë aftësinë e sektorit për të komunikuar në mënyrë strategjike,
- optimizojë proceset e udhëheqjes dhe menaxhimit në kuadër të sektorit,
- përmirësojë komunikimin ndërsektorial si një imperative të zgjidhjeve holistike në kuadrë të mjedisit të kontestuar të sigurisë,
- përmirësojë transparencën dhe llogaridhënen,
- përmirësojë procedurat ligjvënëse,
- përmirësojë efikasitetin dhe shkurton kohën dhe kostot,
- përmirësojë rikthimin e investimit,
- rris gjithëpërfshirjen dhe besimin.

¹ DCAF, SSR BACKGROUNDER, Security Sector Governance, disponueshme në https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/DCAF_BG_1_Security_Sector_Governance_EN.pdf

KONTEKSTI

Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut ka kaluar nëpër procese të reformave të paçmueshme dhe të vlerësuara që siguruan një kornizë konceptuale për funksionimin liberal demokratik në kuadër të sistemit të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave civile. Ndryshe nga më parë, legjislacioni bashkëkohor ofron hapësirë për mbikëqyrje të përmirësuar dhe llogaridhënie dhe transparencë më të madhe. Megjithatë, trajektorja e reformave kërkon një proces dinamik dhe të pandërprerë me përfshirjen e tërësishme dhe gjithëpërfshirëse të të gjithë aktorëve përkatës.

Ky udhërrëfyes bazohet në faktin se nuk ka tregues të vendosur ose ndonjë metrikë objektive të veçantë për të matur cilësinë – efektivitetin dhe performancën e sektorit të zbulimit dhe sigurisë (me theks në operacionet dhe shpërndarjen transparente dhe llogaridhënese). Në mungesë të këtyre treguesve, disa nga zyrtarët e sektorit të zbulimit dhe sigurisë kanë përdorur tashmë tregues të përcaktuar lirshëm ose të vetëpërcaktuar për të vërtetuar/nënkuptuar se transparenca dhe llogaridhënia janë në vend (sipas konkluzioneve të diskutimit të grupit nominal).

Qasja metodologjike

Për qëllime të hulumtimit dhe zhvillimit të treguesve, gjatë 6 muajve është përdorur një metodologji cilësore e kombinuar.

- **Studimi kontekstual (paraprak)** që kombinon dy qasje metodologjike: *një desk analizë, dhe analizë cilësore* përmes intervistave të drejtpërdrejta, gjysmë të strukturuar dhe pyetësorëve të hapur me përfaqësues nga institucionet e zbulimit dhe sigurisë dhe anëtarët e komiteteve parlamentare të sigurisë dhe zbulimit në Maqedoninë e Veriut.
- **Analiza cilësore përmes diskutimeve të punëtorisë së teknikës nominale të grupit (P TGN) 1** përmes ushtrimeve të personalizuara të bazuara në skenarë. Kjo qasje me shumë palë të përfshira mundësoi përballjen me çështjet përmes zgjidhjes konstruktive të problemeve dhe ideve bashkëpunuese nga përfaqësues të institucioneve të inteligjencës dhe sigurisë dhe aktorë të pavarur (përfaqësues nga OSHC-të, media dhe komuniteti akademik) dhe ndihmoi në shkëmbimin e reflektimeve dhe stimulimin e testimit të praktikave të vendosura. Diskutimi gjeneroi ide, i dha përparësi çështjeve dhe testoi zgjidhjen e problemeve me shumë palë të përfshira për çështje me interes të përbashkët.

Studimi synoi të vinte theksin në sfidat dhe funksionet aktuale në sektorin e zbulimit dhe sigurisë përmes disa variablave, duke përfshirë nivelin e ofrimit të informacionit për publikun e gjerë, potencialin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) për të rritur qeverisjen e mirë të sektorit të zbulimit dhe sigurisë, mundësitë për të mësuar dhe transferuar normat ndërsektoriale, përdorimin e mjeteve digjitale për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien, legjislacionin dhe mekanizmat e llogaridhënies në lidhje me digjitalizimin e sektorit të sigurisë dhe zbulimit, përdorimin e të dhënave personale dhe shkëmbimin e informacioneve, rreziqet dhe hapjen ndaj abuzimit.

SFIDAT KRYESORE QË LIDHEN ME SIGURIMIN E TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES NË EPOKËN DIGJITALE NË MAQEDONINË E VERIUT

Hulumtimi dhe analiza e thelluar identifikuan disa sfida të dallueshme që lidhen me ekosistemin digjital dhe kërkesën për reformë që mund të ekspozohen si më poshtë:

- Dualiteti dhe natyra përçarëse e disa prej teknologjive në zhvillim përshpejtojnë procesin e rishpërndarjes së pushtetit dhe me këtë, ndikojnë në proceset e krijuara të qeverisjes së mirë të mbivendosur nën kornizën liberale të llogaridhënies dhe transparencës;
- Konfigurimet e ndryshme konceptuale në sferën digjitale (e cila është horizontale dhe varet nga përdoruesit e fundit) dhe bota fizike (e cila është vertikale nga lart-poshtë e mishëruar në teorinë e kontratës sociale të qeverisjes) vendosin tensione të pashembullta në ekuilibrin midis sigurisë kombëtare dhe lirive civile;
- Ideja mbi të cilën zhvillohet i gjithë digjitalizimi nuk është ndërtuar për llogaridhënie, por për komunikim, pra parimet e hapjes, lidhjes dhe ndërvarësisë, të gjitha të qenësishme për dixhitalizimin i tejkalojnë supozimet gjeohapësinore mbi të cilat janë hartuar shtetet dhe rregullat dhe parimet që ato kanë krijuar;
- Ndarja e informacioneve dhe funksionimi në një vakum pa sinkronizimin e legjislacionit, procedurave dhe resurseve mbeten një sfidë në një mjedis të ndjeshëm;
- Faktorët socio-ekonomikë dhe politikë që formojnë specifikën e kontekstit imponojnë kufizime në reformat e sektorit të sigurisë të mundësuar nga teknologjia;
- Barrierat personale (efekti i rretheve të mbyllura) dhe administrative shpesh nuk arrijnë të mbajnë ritmin me trajektoren e reformave.

REKOMADNIMET PËR EFIKASITET, TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE MË TË MIRË NË SEKTORIN E ZBULIMIT DHE SIGURISË NË MAQEDONINË E VERIUT

- 1) Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut duhet të ndërtohet në bazë të meritave dhe standardeve profesionale të ankoruara respektivisht të përfshira në kornizën liberale demokratike, në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse;
- 2) Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut duhet t'i nënshtrohet mbikëqyrjes që është e plotë, e qëndrueshme dhe sistematike. Mbikëqyrja duhet të jetë e plotë për sa i përket asaj se 'kush' e kryen mbikëqyrjen, 'kur' kryhet mbikëqyrja dhe 'si' organet mbikëqyrëse kryejnë mbikëqyrjen. Kur bëhet fjalë për atë se "kush" kryen mbikëqyrjen, kjo duhet të përfshijë qeverinë, parlamentin, gjyqësorin dhe një organ të specializuar (jo parlamentar, me bazë civile të pavarur). Shoqëria civile duhet të luajë një rol aktiv gjithashtu, duke supozuar se është e pavarur dhe e informuar siç duhet. Kur bëhet fjalë për atë se "kur" mbikëqyrja duhet të kryhet, ajo duhet të përfshijë mbikëqyrje paraprake, të vazhdueshme dhe pas fakteve. Për sa i përket asaj se "si" mbikëqyrja duhet të realizohet/kryhet, mbikëqyrja duhet të përqendrohet në rishikimet e ligjshmërisë dhe efektivitetit. Për sa i përket asaj se "çfarë" mbikëqyrja duhet të marrë në konsideratë, ajo duhet të projektohet dhe ndërtohet për të mbuluar të gjitha fazat e cikleve të punës së zbulimit dhe sigurisë. Kjo do të thotë se mbikëqyrja merr në konsideratë mbledhjen e të dhënave, ruajtjen e të dhënave, përzgjedhjen e të dhënave dhe analizën e të dhënave.
- 3) Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut duhet t'i nënshtrohet mbikëqyrjes që është plotësisht e financuar, e trajnuar dhe e pajisur. Përdorimi i justifikimeve të tilla si legjislatura komplekse thjesht po dëmton imazhin dhe me atë aftësitë për performancën profesionale të sektorit dhe minon besimin e publikut.. Qeveria duhet të sigurojë që organet mbikëqyrëse të kenë mjete të duhura, programe për ngritjen e kapaciteteve dhe burime përkatëse për të kryer mbikëqyrje..
- 4) Rruga normative duhet të jetë e lidhur ngushtë me shqyrtimin para dhe pas legjislativ të ligjeve të zbulimit dhe sigurisë në lidhje me zbatimin e tyre pragmatik për të mbrojtur kornizën legjislative, normative dhe rregullore më efikase dhe të qëndrueshme.

REKOMANDIMET PËR EFIKASITET, TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE MË TË MIRË NË SEKTORIN E ZBULIMIT DHE SIGURISË NË MAQEDONINË E VERIUT

- 5) Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut ka nevojë për digjitalizim që do të rrisë performancën dhe efektivitetin e tij, por gjithashtu do të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe besimin e popullatës. Digjitalizimi i urdhrave të gjykatave pritet të rrisë efikasitetin në shkëmbimin elektronik të të dhënave dhe informacionit që rrjedhimisht do të zvogëlojë kohën dhe do të rrisë besimin e publikut. Por rreziqet duhet të merren parasysh gjithashtu. Përshtatshmëria e mbrojtjes digjitale përmes teknikave përkatëse të enkriptimit është vendimtare për përfundimin e qetë dhe efektiv dhe realizimin e proceseve të vazhdueshme të digjitalizimit. Kjo përfshin qasje me shumë palë të interesuara dhe mësim ndërinstitucional midis palëve të përfshira përkatëse në ndërtimin e një ekosistemi të fortë dhe të sigurt të sektorit të sigurisë digjitale.
- 6) Ndërsa përqafon digjitalizimin, sektori i zbulimit dhe sigurisë i Maqedonisë së Veriut duhet të marrë parasysh sfidat e konvergjencës që shoqërojnë procesin dhe ndërtojnë kapacitetet e tij (kapitali njerëzor, teknologjitë dhe proceset) të ankoruara në praktika të mira liberale demokratike që favorizojnë llogaridhënien dhe transparencën.
- 7) Aktorët e sektorit të sigurisë duhet të marrin në konsideratë digjitalizimin në një kuptim më të gjerë, i cili mund të sigurojë transparencë më të madhe duke përdorur teknologjinë digjitale për baza të dhënash më të arritshme në internet me dokumente përkatëse (legjislative dhe politike) që do ta bënin më të lehtë kryerjen e mbikëqyrjes. Kjo do t'i bëjë institucionet më gjithëpërfshirëse dhe më të hapura për mbikëqyrje.
- 8) Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut duhet të marrë në konsideratë përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve për përmirësimin e aftësive strategjike të komunikimit, shtrirjen e publikut dhe ndërtimin e besimit me sektorin civil dhe mediat.
- 9) Sektori i zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut duhet të marrë parasysh ndryshimin kulturor nga shmangia e rrezikut në menaxhimin e rrezikut për të përmbushur kërkesat e reformës gjithnjë të nevojshme me të gjitha përfitimet dhe rreziqet e lidhura.

TREGUESIT E PERFORMANCËS PËR SEKTORIN E ZBULIMIT DHE SIGURISË PËR EFIKASITETIN, TRANSPARENCËN DHE LLOGARIDHËNIEN

Këta tregues janë krijuar për t'i shërbyer udhëheqjes së sigurisë, vendimmarrësve dhe punonjësve në institucionet e inteligjencës dhe sigurisë si **metrikë të besueshme dhe objektive** në matjen/verifikimin e performancës (rezultatet e arritura) dhe në mënyrë sistematike për të adresuar boshllëqet në lidhje me parimet e qeverisjes së mirë të sektorit të sigurisë. Ata gjithashtu mund t'u shërbejnë aktorëve të pavarur (OSHC-ve, mediave dhe komunitetit akademik) në ushtrimin e funksioneve të tyre të kontrollit civil. Treguesit ndahen në tre kategori: 1) Efektiviteti dhe efikasiteti, 2) Transparenca dhe 3) Llogaridhënia. Ato janë sasiore (me vlerë të paracaktuar) dhe cilësore (përshkruese). Treguesit janë specifikë për kontekstin, të përshtatur për të pasqyruar realitetin lokal dhe bazohen në të dhënat primare (kontributi i drejtpërdrejtë përmes metodës së strukturuar të diskutimeve nominale në grup, pyetësorët e hapur dhe intervistat individuale me përfaqësues të sektorit të zbulimit dhe sigurisë në Maqedoninë e Veriut, organet mbikëqyrëse dhe aktorët e pavarur).

Treguesit e performancës për sektorin e zbulimit dhe sigurisë për efikasitetin, transparencën dhe llogaridhëniën (metrikë të besueshme dhe objektive)						
Spektori në fjalë	Treguesi	Lloji	Vlera e referencës (për treguesit sasiore)	Burimi i verifikimit	Prioriteti	Veprimi i nevojshëm
Kategoria 1: Efektiviteti dhe efikasiteti						
Agjencia teknike operative (ATO)	Sistemet/mjetet/ personeli në vend dhe në mbështetje të digjitalizimit	cilësore	/	raporte vjetore	E lartë	Përforcimi i procedurave; mbështetja teknike; heqja e barrierave administrative
Agjencia teknike operative (ATO)	Sistemi i digjitalizuar për përpunimin e urdhrave të gjykatës për SIM është funksional dhe operativ	cilësore	/	raportet e gjykatës	I lartë	Reduktimi i barrierave administrative
Spektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Përqindja e stafit të trajnuar për të përdorur mjetet digjitale	sasiore	>30%	raportet e vlerësimit	Mesatare	Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve; trajnime profesionale
Spektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Niveli i optimizimit të personelit (më pak staf/koha e nevojshme për të ofruar shërbim)	cilësore	/	diskutime të drejtpërdrejta ose intervista gjysmë të strukturuar me stafin	Mesatare	Lehtësimi i procedurave; mbështetje teknike
Spektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Numri i raporteve të mbikëqyrjes me shënime progresi	sasiore	> 3 në vit	raportet e mbikëqyrjes	E lartë	Takime për ngritjen e vetëdijes

Treguesit e performancës për sektorin e zbulimit dhe sigurisë për efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien (metrikë të besueshme dhe objektive)

Sektori në fjalë	Treguesi	Lloji	Vlera e referencës (për treguesit sasiore)	Burimi i verifikimit	Prioriteti	Veprimi i nevojshëm
Kategoria 2: Transparenca						
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Dokumentet dhe rregulloret legjislative dhe të politikave janë lehtësisht të arritshme dhe të disponueshme për publikun	cilësore	/	uebfaqet	E lartë	Fushatat për ngritjen e vetëdijes; dialogu për politikë
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Ekziston një strukturë organizative transparente (kush, çfarë, pse)	cilësore	/	uebfaqet	Mesatare	Fushatat për ngritjen e vetëdijes; dialogu për politikë
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Informacionet adekuate për përvetësimet buxhetore (politikë financiare, buxheti, shpenzimet)	cilësore	/	uebfaqet	Mesatare	Fushatat për ngritjen e vetëdijes; dialogu për politikë
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Numri i intervistave, deklaratave publike dhe njoftimeve për shtyp të dhëna nga udhëheqja e zbulimit dhe sigurisë	sasiore	>3 në vit	ueb/internet/media kryesore	I lartë	Fushatat për ngritjen e vetëdijes; dialogu për politikë
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Shumëllojshmëria e mediave dhe platformave të përdorura për komunikim me publikun	cilësore	/	ueb/internet/media kryesore	Mesatare	Fushatat për ngritjen e vetëdijes; dialogu për politikë
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Rritet numri i nismave të bashkëpunimit me aktorë të pavarur	sasiore	>3 në vit	regjistri i marrëveshjeve të bashkëpunimit	E lartë	Përmirësimi i shtrirjes dhe kontrollit civil

Treguesit e performancës për sektorin e zbulimit dhe sigurisë për efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien (metrika të besueshme dhe objektive)

Sektori në fjalë	Treguesi	Lloji	Vlera e referencës (për treguesit sasiore)	Burimi i verifikimit	Prioriteti	Veprimi i nevojshëm
------------------	----------	-------	--	----------------------	------------	---------------------

Kategoria 3: Llogaridhënia

Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Raportet e llogaridhënies në fuqi (përgjegjshmëria)	cilësore	/	raportet e vlerësimit (nëse është e mundur); diskutime të drejtpërdrejta me udhëheqjen e sigurisë	E lartë	Trajnime për integritetin
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Niveli i llogaridhënies së vështirë (përgjegjshmëria + mekanizmat për përgjegjësinë personale)	cilësore	/	rregulloret e brendshme (nëse janë të disponueshme publikisht)	E lartë	Zhvillimi i strategjive të orientuara nga sistemi; Rritja e ndërgjegjësimit
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Përgjegjësia vertikale në vend: pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në vendimmarrje, mbikëqyrje dhe kontroll demokratik	cilësore	/	raportet e vlerësimit (intervista, fokus grupe); raportet e vlerësimit nga aktorë të pavarur	Mesatare	Mbështetja e aktiviteteve të pavarura monitoruese, përpjekjet e mbikëqyrësit, shqyrtimi publik
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Llogaridhënia horizontale: komunikim, koordinim dhe raportim më i mirë ndërmjet institucioneve, sektorëve dhe agjencive	cilësore	/	raportet e vlerësimit (intervistat, fokus grupet)	Mesatare	Mbështetje nga bashkëmoshat arët, takime, vizita shkëmbimi; standarde të qarta për raportim
Sektori i zbulimit dhe sigurisë në përgjithësi	Niveli i besimit të publikut në shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë	sasiore	>30%	anketa, sondazhe	E lartë	Forcimi i komunikimit midis aktorëve të sektorit të zbulimit dhe sigurisë dhe aktorëve të pavarur (OJQ, media...)

Vërejtjet përmbyllëse

Diskutimet nominale në grup identifikuan disa mendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me perceptimet e përgjithshme të shërbimeve të zbulimit dhe sigurisë. Si përfaqësuesit e institucioneve të sigurisë, ashtu edhe aktorët e pavarur janë të mendimit se ofrimi i informacionit për publikun e gjerë është një segment i rëndësishëm në ndërtimin e transparencës dhe llogaridhënies, por ndjeshmëria e veprimeve pengon hapjen e institucioneve.

Shoqatat kryesore të përfaqësuesve të aktorëve të pavarur (OSHC, media dhe komuniteti akademik), kur përmenden institucionet e sigurisë dhe zbulimit dhe puna e tyre, janë ngurtësia, burokracia dhe mbyllja. Këta aktorë ende i perceptojnë shërbimet e sigurisë dhe zbulimit në një mënyrë tradicionale, si organe, funksioni i të cilave është kryerja e operacioneve të errëta/klandestine, dhe jo si ofrues të sigurisë në dispozicion.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e institucioneve kanë një pikëpamje më të moderuar për këtë çështje dhe besojnë se me strategjitë e duhura të komunikimit dhe fushatat informative, komuniteti i sigurisë dhe zbulimit mund të jetë më afër publikut dhe të rrisë besimin në institucionet e zbulimit dhe sigurisë.

Megjithatë, shumica e pjesëmarrësve ranë dakord se ka mungesë njohurish dhe mirëkuptimi midis publikut se si të mbahet përgjegjës sektori i sigurisë. Megjithatë, ata pajtohen se demokratizimi i sektorit të sigurisë duhet të bazohet në parimet e pjesëmarrjes, hapjes ndaj kontrollit publik dhe transparencës, të cilat, ndër të tjera, do të forcojnë legjitimitetin demokratik të institucioneve të sigurisë.

Kur bëhet fjalë për funksionalitetin e punës, shumica e pjesëmarrësve janë të pozicionuar se performanca e sektorit të sigurisë do të ishte shumë më e lartë nëse komuniteti i sigurisë mbështetet në mjetet digjitale bazuar në praktikën e mira, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mekanizmat e mirëpërcaktuar të llogaridhënies. U konstatua se megjithëse ka një përparim të rëndësishëm në vitet e fundit në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së sektorit të zbulimit dhe sigurisë, megjithatë, ka ende mangësi dhe boshllëqe në legjislacionin në sigurimin e transparencës së plotë dhe disponueshmërisë së informacionit, duke qenë se shumica e kornizës legjislative është ose jo e saktë ose nuk ka dispozita specifike që rregullojnë garancitë e transparencës dhe llogaridhënies. Edhe pse shkalla e angazhimit nuk është e njëjtë në të gjitha institucionet e sigurisë, nevoja për të intensifikuar përpjekjet për të mbushur boshllëqet në llogaridhënie dhe transparencë është më se e dukshme dhe ato duhet të veçohen bazuar në nevojat institucionale.

Treguesit e mësipërm do t'u shërbejnë aktorëve të sektorit të zbulimit dhe sigurisë për të monitoruar ecurinë e zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë të sektorit të sigurisë, por edhe aktorëve të pavarur (OSHC-ve, mediave dhe komunitetit akademik) në ushtrimin e funksioneve të tyre të kontrollit civil. Monitorimi i treguesve nuk është i kufizuar në kohë dhe kërkon monitorim të qëndrueshëm, por duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe rishikimit të rregullt në përputhje me ndryshimet kontekstuale.

